



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH**

Numri i lëndës: 2022:218177

Datë: 13.01.2025

Numri i dokumentit: 06703771

**PPP.nr.9/22**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Sabaheta Kurteshi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike të përmbarrimit sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit KESco – sh.a. me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Kllinton Nr.5, Ndërtesa Elektro Kosovës, Kati VII, kundër debitorit S. S. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, për përmbarrimin e dokumentit të besueshëm të përmbarrimit – Ekstraktit nga librat afariste Nr. DPZ- 145... të dt. 09.09.2022, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 1,755.98 € (njëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e tetë centi), dhe i lejuar me Urdhërin për përmbarrim, P.nr.534/22 të dt. 09.09.2022 të Përmbarruesit Privat R. H. nga Prizreni, duke vendosur sipas prapësimit (kundërshtimit) të ushtruar nga debitori i përmbarrimit S. S. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, kundër Urdhërit për Përmbarrim P.nr.534/22 të dt. 09.09.2022, jashtë seancës gjyqësore me dt. 13.01.2025, mori këtë:**

**A K T V E N D I M**

**I.APROVOHET PJESËRISHT** prapësimi i debitorit S. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, ashtu që:

**II.SHFUQIZOHET PJESËRISHT** Urdhëri mbi lejimin e Përmbarrimit P.nr.534/2022 të dt. 09.09.2022 për periudhën kohore 30.08.2014 e gjerë me 31.12.2020 në shumë prej 1,283.38 €, dhe **OBLIGOHET** debitori S. S. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit që kreditorit KESco Sh.a me seli në Prishtinë, në emër të borxhit për konsumin e energjisë elektrike të harxhuar për periudhën kohore 28.01.2021 e gjerë me 11.08.2022 t'ia paguaj shumën prej 472.60 (katërqind e shtatëdhjetë e dy euro e gjashtëdhjetë centi) €, me kamatë ligjore në lartësi prej 8% nga dita e nxjerrjes se të këtij aktvendimi e deri ne pagesen definitive te detyrimit, te gjitha keto ne afat 7 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit nën kërcënim të përmbarrimit te detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Kreditori, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (Kesco), me seli në Prishtinë, me datën 09.09.2022, në zyrën e Përmbarruesit Privat Përparim R. H. me seli në Prizren, ka paraqitur propozim për përmbarrim, kundër debitorit S. S. K. nga fshati..., Komuna e

Dragashit me vlerë të kredisë prej 1,755.98 euro, në bazë të dokumentit përmbarues, Kartelës së Konsumatorit nga data 30.08.2014 deri me datë 11.08.2022.

Përmbaruesi Privat Përparim R. H. nga Prizreni, me Urdhërin Përmbarimor P.nr.534/22, i datës 09.09.2024, e ka lejuar përmbarimin, sipas propozimit për përmbarim të lartcekur.

Debitori, me datën 13.10.2024, në zyrën e Përmbaruesit Privat, ka paraqitur prapësim kundër Urdhërit Përmbarimor P.nr.534/22, i datës 09.09.2022, duke theksuar se urdhëri përmbarimor është marrë me shkelje qenësore të dispozitave të LPP-së, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe me aprovimin e kërkesave të cilat sipas dispozitave të LMD-së tashmë janë parashkruar, duke theksuar se kërkesa konform nenit 360 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të LMD-së është parashkruar, prandaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet pjesërisht urdhëri përmbarimor P.nr.534/22 i datës 09.09.2022.

Kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (Kesco), me seli në Prishtinë, me datë 19.10.2022 ka paraqitur përgjigje kundër prapësimi të lartëcekur të debitorit, duke theksuar se i kundërshton në tërësi deklaratimet e debitorit të theksuara në prapësim, pasi që propozimit për përmbarim i është bashkangjitur ekstrakti nga librat afarist, si dokument i besueshëm në bazë të LPP-së, ndërsa nuk qëndron pretendimi i debitorit se borxhi është parashkruar, debitori ka bërë pagesa vullnetare, gjë që ka shkaktuar ndërprerjen e parashkrimit konform nenit 368 të LMD-së, po ashtu ka theksuar se prapësimi ndaj urdhërit për përmbarim të lartcekur nuk është në përputhje me nenin 69 të LPP-së, dhe i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi, dhe të mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve gjeti se prapësimi i debitorit i datës 13.10.2022, është pjesërisht i bazuar, pasi dokumentit të besueshëm mbi bazën e të cilit është lëshuar urdhëri përmbarimor, i ka skaduar afati kohor, sa i përket një pjese të saj. Gjykata deri te kjo gjetje erdhi në bazë të kartelës së konsumatorit ku shihet se propozimi për përmbarim është bërë me datë 09.09.2022 ndërsa duke u bazuar në nenin 360, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i cili përcakton se *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”* dhe paragrafit 2 i cili përcakton se *“Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”* ndërsa debitori është thirrur në parashkrim për vitet 2014 – 2020 andaj gjykata gjeti që konform nenit 360 të LMD-së borxhi për këto vite është parashkruar, ndërsa lartësia e borxhit që nga data 28.01.2021 është në lartësi prej 472.60 euro, përkatësisht lartësia e pjesës që nuk është përfshirë në parashkrim, duke u zbritur nga shuma e përgjithshme prej 1,283.38 euro e kërkuar nga kreditori bazuar në urdhërin për përmbarim, gjë që vërtetohet edhe nga kartela e konsumatorit bashkangjitur propozimit për përmbarim nga vet kreditori.

Sa i përket pretendimit të kreditorit se debitori në kohë të papërcaktuara ka bërë pagesën e shumave të papërcaktuara të borxhit, dhe me këto veprime ka shkaktuar ndërprerjen e parashkrimit, gjykata gjeti se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndërprerje të rrjedhës së parashkrimit, ngase me nenin 368 par.2 përcaktohet mënyra e ndërprerjes së parashkrimit *“Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*. Në rastin konkret pagesa e debitorit nuk hynë në kategorinë e pagesës të kësteve të cekura më lartë pasi që kësti konsiderohet ndarje e borxhit në periudha të caktuara mujore apo më gjatë, ku borxhi i përgjithshëm ndahet në pjesë më të vogla për pagesë për një periudhë të caktuar. Pagesë e këstit

do të mund të llogaritej nëse do të ekzistonte një marrëveshje në mes të kreditorit dhe debitorit, qoftë për ri programim të borxhit apo për pagesë të borxhit total të ndarë në këste, ndërsa kjo assesi nuk i atribuohet pagesave të debitorit, sepse edhe pse kemi borxh të akumuluar nga faturat mujore nuk kemi marrëveshje për ndarje me këste në mes të palëve, dhe pa një marrëveshje të tillë pagesat nuk trajtohen këste.

Dispozita ligjore qartë e përcakton dhe nuk e cek faturën e as shumë më të madhe sesa fatura, sepse pala gjatë pagesës ka mundësi të paguaj më tepër sesa ka borxh dhe ajo i llogaritet si paradhënie për muajin tjetër, por asesi kjo nuk llogaritet këst.

Interpretimi i Gjykatës në raport me dispozitën e cituar më lartë është se pa marrëveshje të kreditorit dhe debitorit për pagesën e borxhit me këste, pagesat e kohëpaskohshme assesi nuk mund të trajtohen apo konsiderohen si këste në vetvete.

Andaj nga të lartcekurat gjykata gjeti se për pjesën e borxhit deri në vitin 2020 kreditorit i është parashkruar kërkesa, ndërsa për pjesën prej vitit 2021 e tutje, gjykata ia la në fuqi urdhërin përmbartimor në fjalë, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat më lart e në pajtim me nenin 5, 17, 29, 71, 73 të LPP-së, u vendos si në pikën I dhe II të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL  
2022:218177, 13.01.2025**

**Gj y q t a r j a,**

---

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.